LIGJ
Nr.7602, datë 9.9.1992

PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuse", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Garda e Republikës së Shqipërisë është njësi ushtarake e specializuar për ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe të selive e rezidencave të përcaktuara në këtë ligj. Ajo bën pjesë në strukturën e Ministrisë së Rendit Publik dhe varet nga ministri.

Neni 2

Garda e Republikës merr në ruajtje:

a) Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kryesisë së Kuvendit Popullor dhe Kryetarin e Këshillit të Ministrave.

b) Zëvendëskryetarët e Kuvendit Popullor, anëtarët e Qeverisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, Kryetarin e Gjykatës së Kasacionit, Kryetarin e SHIK-ut dhe Kryetarin e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit.

c) Personalitete të huaja që vinë në vendin tonë me rang të njëjtë me ata që përcaktohen në shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, si dhe personalitete të tjera të huaj dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, kur çmohet nga Ministri i Rendit Publik.

ç) Rezidencën e Presidentit, selitë e Kuvendit Popullor e të Këshillit të Ministrave dhe rezidencat e tjera qeveritare që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Presidenti i Republikës së Shqipërisë ruhet edhe 4 vjet pas lirimit nga funksioni, kurse Kryetari i Kryesisë së Kuvendit Popullor dhe Kryetari i Këshillit të Ministrave edhe 2 vjet pas lirimit nga funksioni, kur ata kanë plotësuar më tepër se gjysmën e kohës së mandatit të tyre.

Neni 4

Personaliteteve të larta që përcaktohen në nenin 2, shkronjat "a" dhe "c" dhe në nenin 3 të këtij ligji, u ruhet banesa ose rezidenca ku ndodhen si dhe u sigurohet ruajtja e afërt fizike kur janë jashtë saj.

Zëvendëskryetarëve të Kuvendit Popullor, zëvendëskryetarëve të Këshillit të Ministrave, ministrit të Rendit Publik, ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Mbrojtjes u sigurohet ruajtja e afërt fizike, kur ndodhen jashtë banesës së tyre. Në raste të veçanta me vendim të Këshillit të Ministrave, mund t'u ruhet edhe banesa.

Personaliteteve të tjera shtetërore që përcaktohen po në shkronjën "b" të nenit 2 të këtij ligji, u sigurohet vetëm ruajtja e afërt fizike, kur ndodhen jashtë kryeqytetit.

Neni 5

Garda e Republikës siguron ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore, që përcaktohen në nenin 2, shkronjat "a" dhe "b", dhe në nenin 3 të këtij ligji, kur shkojnë jashtë shtetit, duke

bashkëvepruar me organet përkatëse të shtetit pritës nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Neni 6

Në objekte e veprimtari ku marrin pjesë Presidenti i Republikës, Kryetari i Kryesisë së Kuvendit Popullor, Kryetari i Këshillit të Ministrave, grup personalitetesh që përcaktohen në nenin 2, shkronja "b", ose pjesëtarë të delegacioneve të huaja që parashikohen në shkronjën "c" të nenit 2 të këtij ligji, Garda e Republikës kërkon zbatimin e rregullave të veçanta, të caktuara nga Ministri i Rendit Publik.

Neni 7

Garda e Republikës organizon dhe kryen të gjitha pritjet ceremoniale sipas përcaktimit që bëhet nga protokolli i Presidencës, Kuvendit Popullor, Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Për ceremonitë zyrtare të rangut të lartë Garda organizon truproje nderi të posaçme, e cila vishet me uniformë të veçantë.

Shërbimi ceremonial në Selinë e Presidentit kryhet me uniformë të veçantë.

Neni 8

Ruajtja e personaliteteve të larta shtetërore realizohet nga forcat e Gardës në bashkëveprim me shërbimet e tjera të Ministrisë së Rendit Publik, me Shërbimin Informativ Kombëtar, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Mbrojtjes dhe organet e tjera shtetërore në qendër e rrethe.

Neni 9

Rregullat për hyrjen dhe daljen në rezidencat kryesore parlamentare, presidenciale e qeveritare përcaktohen nga titullarët përkatës të tyre, në bashkëveprim me Ministrinë e Rendit Publik.

Neni 10

Personat juridikë dhe fizikë detyrohen t'u krijojnë kushte lehtësuese shërbimeve të Gardës, kur në ndërtesa ose në afërsi të tyre zhvillohen veprimtari, për të cilat ajo është ngarkuar me detyra në zbatim të këtij ligji.

Neni 11

Komandanti i Gardës së Republikës emërohet nga Presidenti me propozimin e Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Organika e Gardës, kriteret e kompletimit dhe uniforma e saj miratohen nga Këshilli i Mbrojtjes.

Neni 13

Plotësimi me ushtarë aktivë bëhet nga Ministria e Mbrojtjes nëpërmjet Ministrisë së Rendit Publik, mbi bazën e këtyre kritereve:

- Të jenë shtetas shqiptarë.
- Të kenë sjellje të mira morale.
- Të kenë përfunduar shkollën e mesme.
- Të kenë përgatitje të lartë fizike dhe gjatësi mbi 1.75m.

Neni 14

Kuadrot dhe punonjësit e Gardës së Republikës pajisen me dokumente të posaçme, për t'i paraqitur gjatë kryerjes së detyrës.

Neni 15

Në rastet kur shpallet gjendje lufte ose gjendje e jashtëzakonshme, në vartësi operative të Gardës dhe vetëm me urdhër të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura kalojnë edhe njësi e reparte të llojeve të ndryshme të armëve të ushtrisë. Këto njësi e reparte të ushtrisë parashikohen në planin operativo-strategjik të mbrojtjes dhe emërohen "gardistë".

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.322, datë 15.10.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.